

FORMULARI I ANKESËS PRANË AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR DHE KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Ankesë drejtuar: Autoriteti/Entit Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik

Seksioni I. Identifikimi i ankimuesit

Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (p.sh. individ, operator ekonomik, shoqatë, bashkim operatorësh ekonomikë)

Inpress

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

L52122014L

NUIS/NIPT

Ish Blloku i Magazinave të Tregtisë, Rruga Siri Kodra

Adresa

Tiranë

Albania

1001

Qyteti

Shteti

Kodi Postar/Posta

0682069861

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

info@inpress.al

E-mail

Administrator Erald Dervishi

Emri dhe titulli i zyrtarit të autorizuar për lëshimin e ankesës (ju lutemi shkruani)

Nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar

2023/04/26

Data (viti/muaji/dita)

+355682069861

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

Seksioni II: Informacion mbi procedurën

Numri i referencës së procedurës/Lotit

Plotësoni numrin e referencës së kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentin e tenderit.

REF-66518-04-19-2023

Tipi i procedurës për ankesën

Procedure Prokurimi Publik

Tipi i ankesës

Dokumenta Tenderi

Plotësoni llojin e procedurës së përdorur

Open Simple

Autoriteti/Enti Kontraktor

Emri i autoritetit/entit kontraktor që administron procesin e prokurimit.

Autoriteti Portual Durres

Vlera e përlogaritur e prokurimit

Vlera e përlogaritur e kontratës/Marrëveshjes Kuadër (shuma në shifra dhe fjalë)

1433300

Objekti i kontratës/Marrëveshjes Kuadër

Përshkrimi i shkurtër i punëve/mallrave/shërbimeve objekt kontrate/marrëveshje kuadër.

Shtypshkrime

Afati i fundit për paraqitjen e ofertës

Data (viti/muaji/dita)

2023/05/03

Data e publikimit të Njoftimit të Fituesit

(Data (viti/muaji/dita) nëse është e zbatueshme)

Data e nënshkrimit të kontratës

(Data (viti/muaji/dita) në rastet e kërkesave për pavlefshmërinë e kontratës)

Tipi i kontratës

Data e zhvillimit të procedurës

Mallra

2023/05/03

Numri i njoftimit

Kodi CPV

CN/15677/04192023

79800000-2

Ankese mbi argument në KPP

Seksioni III: Përshkrimi i ankesës

1. Baza ligjore

(Shkelje/arsyetime ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente, etj.)

Në mbështetje të pikës 1 të nenit 110 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; si dhe Vendimit nr. 285, datë 19.5.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik.

2. Objekti i ankesës

- Modifikim i dokumentave të tenderit

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës tuaj.

(Citoni këtu arsyet e skualifikimit)

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të një/disë operatori/ëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

(Citoni operatorin/ët ekonomik për të cilin keni pretendime)

- Pavlefshmëri kontrate

(Citoni kontratën për të cilën kërkoni pavlefshmërinë)

- Tjetër

(Citoni këtu objektin e ankesës që nuk përfshihet më sipër)

3. Rrethanat dhe faktet □

Përshkruani rrethanat e faktit. □

Të nderuar zotërinj,

Në vijim të të procedurës së prokurimit publik të Autoritetit Kontraktor Autoriteti Portual Durrës, me objekt: “Shtypshkrime”, dhe me Fond limit: 1,433,300 (një milion e katërqind e tridhjetë e tre mijë e treqind) Lekë pa TVSH, publikuar me datë 20.04.2023, brenda afatit 7 ditor nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen e internetit të APP-së, të parashikuar nga pika 1 e nenit 110, e Ligjit Nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, mëposhtë Ju parashtrajmë kundërshtitë tona për dokumentet e tenderit dhe arsyet ligjore ku bazohen këto kundërshti:

* * *

I.

Rrethanat dhe faktet

Përshkruani rrethanat e faktit.

1. Në pikën 2.2.1. “Kapaciteti ekonomik dhe financiar”, të Shtojcës 7 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, të Dokumentave Standarte të Tenderit të sipërcituar, përcaktohet:

“2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2019,2020,2021), ku vlera e xhiros vjetore, per te paktën nje nga vitet e periudhes se kerkuar, nuk duhet të jetë më e vogël se 40% e vlerës së përlogaritur të fondit limit.”

Ky kriter i veçantë i kualifikimit - OE duhet të paraqesin ”...vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2019,2020,2021)...”, bazuar në kërkesat e autoritetit kontraktor për mallrat e prokuruarra është në kundërshtim me LPP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, dhe për këtë arsye do të duhet të ndryshohet.

II.

Rrethanat dhe faktet

Përshkruani rrethanat e faktit.

1. Në pikën 2.3.3. “Kapacitet teknike”, të Shtojcës 7 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, të Dokumentave Standarte të Tenderit të sipërcituar, përcaktohet:

“2.3.3. Operatori Ekonomik duhet të ketë në stafin e tij minimalisht 2 (dy) punonjës të jenë me arsim të lartë në profilin Marketing dhe Artet e aplikuara, Dega Grafike, si dhe minimalisht një teknik printimi të certifikuar të paktën 3 muajt e fundit nga data nga data e zhvillimit të tenderit Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti Operatori Ekonomik duhet të paraqesë listë/deklaratë të firmosur nga Administratori i shoqërisë.

Lista e personelit kryesor duhet të shoqërohet me:

1- Listëpagesat e sigurimeve shoqërore (formularët E-sig 025)

2- Për teknikun e printimit të paraqitet certifikata dhe CV.”

Ky kriter i veçantë i kualifikimit, bazuar në kërkesat e autoritetit kontraktor për mallrat e prokuruarra

është i) diskriminues, ii) jo – në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që po prokurohet, dhe iii) nuk do të duhet të konsiderohet i përshtatshëm, dhe për këtë arsye do të duhet të hiqet / ndryshohet.

III.

Rrethanat dhe faktet

Përshkruani rrethanat e faktit.

1. Në pikën 2.3.4. “Kapacitet teknike”, të Shtojcës 7 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, të Dokumentave Standarte të Tenderit të sipërcituar, përcaktohet:

“2.3.4. Operatori ekonomik ofertues brenda datës dhe orës së hapjes së kësaj procedure duhet të paraqesë për Zyrës së Protokollit nga një mostër për zërat si më poshtë:

1) Axhendë

2) Bllok

3) Kartëvizita

4) Kartolina + Zarfa

5) Bazament për flamur tavoline

6) Stilolaps”

4. Argumentime mbi shkeljet e pretenduara

Përshkruani në mënyrë koncize shkeljet e pretenduara, duke argumentuar qartë dhe saktë se përse pretendoni për paligjshmëri në veprimet e autoritetit/entit kontraktor.

Argumentime mbi shkeljet e pretenduara

Përshkruani në mënyrë koncize shkeljet e pretenduara, duke argumentuar qartë dhe saktë se përse pretendoni për paligjshmëri në veprimet e autoritetit kontraktor.

Të nderuar zotërinj,

Bazuar në LPP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, autoritetet kontraktore mund të kërkojnë dokumentacionin e nevojshëm ligjor i cili vërteton xhiron vjetore të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës të 3 (tre) viteve të fundit.

Rrjedhimisht, AK Autoriteti Portual Durrës do të duhet të kërkonte nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës paraqitjen e vërtetimit për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021, 2022, dhe jo për vitet financiare 2019, 2020, 2021, siç është përcaktuar në DST.

Përsa mësipër, kërkojmë ndryshimin e këtij kriteri kualifikues, sipas parashtrimeve të lartpërmendura të kësaj Ankese.

* * *

Argumentime mbi shkeljet e pretenduara

Përshkruani në mënyrë koncize shkeljet e pretenduara, duke argumentuar qartë dhe saktë se përse pretendoni për paligjshmëri në veprimet e autoritetit kontraktor.

Të nderuar zotërinj,

a) Së pari, Në DST kërkohet në mënyrë të kundraligjshme që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të vërtetojnë disponimin e:

i. minimalisht 2 (dy) punonjës të jenë me arsim të lartë në profilin Marketing dhe Artet e aplikuar, Dega Grafike,

ii. si dhe minimalisht 1 (një) teknik printimi të certifikuar

Ky kriter i veçantë kualifikues, do të duhet të konsiderohet tërësisht në kundërshtim me LPP dhe

Rregullat e Prokurimit Publik, nga KSHA e AK dhe KPP, dhe për këtë arsye do të duhet të ndryshohet / hiqet.

Për atë kohë sa Autoriteti Kontraktor kërkon nga OE pjesëmarrës të kenë në dispozicion një staf të specializuar, që lidhet drejtëpërdrejtë me realizimin e kontratës, dhe në proporcion me shërbimin e kërkuar kjo kërkesë e AK mund të konsiderohet e pranueshme dhe në përputhje me dispozitat e LPP-së.

Por kërkesa e AK, që OE pjesëmarrës të kenë në dispozicion punonjës të cilët duhet të figurojnë në listëpagesat si: i. minimalisht 2 (dy) punonjës të jenë me arsim të lartë në profilin Marketing dhe Artet e aplikuara, Dega Grafike, ii. si dhe minimalisht 1 (një) teknik printimi të certifikuar... është tërësisht jo e lidhur drejtëpërdrejtë me realizimin e kontratës, jo proporcionale; dhe mbi të gjitha në kundërshtim të plotë me LPP.

Siç mund të vihet re lehtësisht, duke iu referuar mallrave që kërkohet të prokurohen, sasisve e vlerës së tyre, dhe mënyrës së prodhimit / realizimit të tyre, ...ky kriter i veçantë kualifikues dhe disponimi i një stafi të tillë të specializuar as nuk lidhet drejtëpërdrejtë me realizimin e kontratës, dhe as nuk është në proporcion me shërbimin e kërkuar

Për realizimin dhe prodhimin e mallrave që kërkohen të prokurohen nuk nevojitet asnjë prej punonjësve të specializuar të përcaktuar në këtë pikë të DST.

Gjithashtu, duke marrë në konsideratë sasinë dhe vlerën e mallrave të kërkuara, lehtësinë e realizimit / prodhimit të këtyre mallrave / produkteve,... kjo kërkesë e AK dhe ky kriter i veçantë kualifikues do të duhet të konsiderohet tërësisht jo proporcional.

Në rastin konkret, mund të jetë e pranueshme dhe e logjikshme që AK të kërkojë nga OE pjesëmarrës disponimin e 1 (një) Dizjener, i cili të figurojë në listëpagesat e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, për realizimin dhe prodhimin e mallrave të kërkuara, kërkesë kjo që mund të konsiderohet deri diku e pranueshme dhe në përputhje me dispozitat e LPP-së, si dhe mund të nevojitet, por kurrësi nuk është e nevojshme disponimi i një stafi të tillë të specializuar sipas përcaktimeve të kërkuara në pikën 2.3.3 të shtojcës 7, të DST.

Argumentimi i bërë nga AK se: "Ky kriter është i nevojshëm që Operatorët pjesëmarrës të provojnë besueshmërinë dhe provojnë e tyre në realizimin e kontratës pa vonesa dhe pengesa, që do të ndikonin në ecurinë e punës së AK.",...

...nuk qendon aspak, pasi si përvoja ashtu edhe besueshmëria e një operatori ekonomik pjesëmarrës vërtetohet kryesisht nëpërmjet punëve të ngjashme dhe xhirove vjetore të kërkuara, ndërsa kërkesa për një staf të tillë të specializuar duhet të lidhet kryesisht dhe drejtëpërdrejtë me realizimin e kontratës, dhe për më shumë do të duhet të jetë në proporcion me kontratën e prokuruar.

Rrjedhimisht, ky kriter i veçantë kualifikues do të duhet të ndryshohet nga KSHA e AK dhe KPP, pasi është në kundërshtim të plotë me LPP dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

b) Së dyti, Kriteri i përcaktuar në pikën 2.3.3. "Kapacitet teknike", të Shtojcës 7 "Kriteret e Veçanta të Kualifikimit", të Dokumentave Standarte të Tenderit, me anë të së cilës kërkohet që OE pjesëmarrës të kenë në dispozicion punonjës: i. minimalisht 2 (dy) punonjës të jenë me arsim të lartë në profilin Marketing dhe Artet e aplikuara, Dega Grafike, ii. si dhe minimalisht 1 (një) teknik printimi të certifikuar... të cilët duhet të figurojnë në listëpagesat e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës për 3 muajt e fundit nga data nga data e zhvillimit të tenderit: është gjithashtu tërësisht, diskriminues, jo proporcional; dhe mbi të gjitha në kundërshtim të plotë me LPP.

Nuk ekziston asnjë arsye se përse OE pjesëmarrës do të duhet të disponojnë një staf të tillë të specializuar gjatë gjithë kohës dhe të cilët duhet të figurojnë në listëpagesat e operatorëve ekonomikë

pjesëmarrës për 3 muajt e fundit nga data nga data e zhvillimit te tenderit.

Fare mirë një OE pjesëmarrës mund të disponojnë punonjës të specializuar nëpërmjet kontratave të përkohshme apo me kohë të pjeshme dhe në mënyrë të posaçme për këtë procedurë prokuruese. Pra NUK ka / ekziston asnjë arsye logjike, ekonomike, teknike, profesionale dhe funksionale përse një OE pjesëmarrës do të duhet të punësojë dhe të ketë në dispozicion gjatë gjithë kohës një staf të tillë të specializuar - i cili të figurojë detyrimisht i regjistruar në listëpagesa për 3 muajt e fundit nga data nga data e zhvillimit te tenderit, ku fare mirë për projekte dhe detyra të veçanta, mund të punësojë me kohë të pjeshme apo me kontratë të përkohshme staf të specializuar, i cili të kryejë detyrat dhe funksionet e kërkuara për një projekt të caktuar.

Rrjedhimisht, AK mund të kërkojë që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të mund të disponojnë një staf të specializuar për realizimin e një kontrate të caktuar, por ky staf i specializuar jo detyrimisht do të duhet të jetë i punësuar mëparë pranë operatorit ekonomik pjesëmarrës.

Operatorët ekonomikë të cilët dëshirojnë të marrin pjesë në një procedurë prokuruese, në përputhje me frymën dhe dispozitat e LPP-së dhe Rregullat e Prokurimit Publik do të duhet të kenë të drejtën që të mund të disponojnë punonjës të specializuar edhe nëpërmjet kontratave të përkohshme apo të pjeshme, posaçërisht për një procedurë prokuruese të caktuar.

Komisioni i Prokurimit Publik me anë të vendimeve të tij (dhjetra vendime të tilla të ngjashme) ka pasur mundësinë dhe është shprehur shumë herë dhe qartazi përse i përket kësaj pike dhe këtij kriteri, duke përcaktuar qartësisht se operatorët ekonomikë pjesëmarrës mund të disponojnë staf / personel të specializuar me anë të kontratave të përkohshme apo të pjeshme (për të ardhmen), dhe jo domosdoshmërisht do të duhet që këtë staf / personel të specializuar OE pjesëmarrës ti kenë në dispozicion paraprakisht, në 3 muajt e fundit (në të shkuarën).

Për sa mësipër, kriteri kualifikues që OE pjesëmarrës do të duhet të kenë në dispozicion i. minimalisht 2 (dy) punonjës të jenë me arsim të lartë në profilin Marketing dhe Artet e aplikuara, Dega Grafike, ii. si dhe minimalisht 1 (një) teknik printimi të certifikuar... të cilët duhet të figurojnë në listëpagesat e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës për 3 muajt e fundit nga data nga data e zhvillimit te tenderit: do të duhet të hiqet / ndryshohet, pasi bie në kundërshtim të plotë me LPP.

c) Së Treti, Kriteri i përcaktuar në pikën 2.3.3. “Kapacitet teknike”, të Shtojcës 7 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, të Dokumentave Standarte të Tenderit, me anë të së cilës kërkohet që OE pjesëmarrës të kenë në dispozicion punonjës: i) minimalisht 1 (një) teknik printimi të certifikuar të cilët duhet të figurojnë në listëpagesat e 3 muajve të fundit (i regjistruar detyrimisht me këtë kod) - Për teknikun e printimit të paraqitet certifikata dhe CV: është gjithashtu tërësisht diskriminues, jo i lidhur drejtëpërdrejtë me realizimin e kontratës, jo proporcional; dhe mbi të gjitha në kundërshtim të plotë me LPP.

Përpos faktit të sipërcituar, që një punonjës i tillë i specializuar nuk nevojitet aspak për realizimin e kësaj kontrate prokuruese, gjithashtu, fare mirë një OE pjesëmarrës mund të disponojë punonjës që mund të jenë të regjistruar në listëpagesa me një titullim profesional tjetër si për shembull i) Ofsetist; ii) Dizajner, iii. Faqosës, etj.) dhe në të njejtën kohë të kryejë edhe funksionet dhe detyrat e i) teknikut të printimit.

Pra NUK ka / ekziston asnjë arsye logjike, teknike, profesionale dhe funksionale përse një OE pjesëmarrës do të duhet të ketë një punonjës - i cili të figurojë detyrimisht i regjistruar në listëpagesa si i) teknik printimi – ku fare mirë detyrat dhe funksionet e tij mund ti mbulojë një punonjës tjetër i cili është i regjistruar me një titullim + kod tjetër në listëpagesat e Shtypshkronjës. Gjithashtu, ky kriter i veçantë bie në kundërshtim me vetë objektin e këtij prokurimi publik ”Shtypshkrime”. Vetë AK përcakton që objekti është ”Shtypshkrime”, ndërsa nga ana tjetër kërkon që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të disponojnë një staf të specializuar i) teknik printimi, dhe për më shumë, i cili do të duhet të figurojë në listëpagesat e 3 muajve të fundit (i regjistruar detyrimisht me këtë kod).

Nese AK mendon dhe beson që operatorët ekonomikë pjesëmarrës do të duhet të kenë patjetër në dispozicion një punonjës i cili të kryejë detyrat dhe funksionet e i) i) teknik printimi (i certifikuar) –

kërkesë kjo aspak proporcionale dhe tërësisht jo e lidhur drejtëpërdrejtë me realizimin e kontratës prokuruese, për të cilën patëm mundësi të shprehim kundërshtimet tona në germën a) të kësaj pike – përsëri, kërkesa që ky punonjës të jetë i regjistruar detyrimisht në listëpagesa me këtë titullim + kod, është një kërkesë jo proporcionale, e panevojshme dhe e ekzagjeruar, dhe për këtë arsye do të duhet të ndryshohet.

Për sa mësipër, kriteri kualifikues që OE pjesëmarrës do të duhet të kenë në dispozicion punonjës të cilët duhet të figurojnë në listëpagesat i)) teknik printimi (i çertifikuar); do të duhet të hiqet / ndryshohet, pasi bie në kundërshtim të plotë me LPP.

d) Së katërti, Komisioni i Prokurimit Publik me anë të disa vendimeve të tij, në të tjera procedura prokuruese në fushën e shtypshkrimeve e ka konsideruar këtë kriter të ngjashëm, të kundraligjshëm dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe nënligjore aktualisht në fuqi. Në një prej këtyre vendimeve Komisioni i Prokurimit Publik parashtron sa mëposhtë vijon:

“...Mirëmbajtësi i makinerive të jetë i punësuar dhe të figurojë në listëpagesat e tre muajve të fundit (mars – maj 2022) është kërkesë e ekzagjeruar, e rëndësishme për autoritetin kontraktor është që operatorët ekonomikë të disponojnë punonjës të specializuar për realizimin e kontratës objekt-prokurimi në kohë dhe me cilësi të cilët të jenë punonjës efektivë për sa kohë do të zgjasë realizimi i kontratës, për sa i përket mirëmbajtësit nuk është profesion i domosdosshëm për të qenë i punësuar me kohë të plotë. Operatori ekonomik që merr përsipër realizimin e kontratës është përgjigjes për të realizuar dhe përfunduar në kohë dhe me cilësi shërbimin e kërkuar.

Komisioni Prokurimit Publik gjykon, se një kërkesë e tillë, për disponim të mirëmbajtësit të makinerive (rimontier) është jashtë objektit dhe volumit të kontratës, është e tepruar dhe nuk ndikon në realizimin me sukses të kontratës.”

* * *

Për të gjitha sa u parashtruan mësipër, bazuar në dispozitat ligjore dhe nënligjore të lartpërmendura, gjykojmë se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, pra në proporcion me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet në zbatim LPP-së dhe Rregullave të Prokurimit Publik. Synimi bazë i autoritetit kontraktor duhet të jetë vërtetimi nëse subjektet ofertues zotërojnë ose jo kapacitetet e nevojshme për realizimin e kontratës, duke lehtësuar edhe pjesëmarrjen e operatorëve ekonomike në procedurë, pasi ky është dhe qëllimi i ligjit dhe rregullave të prokurimit publik. Kërkojmë ndryshimin / heqjen e këtij kriteri kualifikues, sipas parashtrimeve të lartpërmendura të kësaj Ankese.

* * *

Argumentime mbi shkeljet e pretenduara

Përshkruani në mënyrë koncize shkelejt e pretenduara, duke argumentuar qartë dhe saktë se përse pretendoni për paligjshmëri në veprimet e autoritetit kontraktor.

Të nderuar zotërinj,

Ky kriter i veçantë i kualifikimit - OE të paraqesë një mostër për zërin ”Kartolina + Zarfa”, është i papërshtatshëm, pasi ky mall / artikull / produkt nuk ekziston në listën e mallrave / artikujve/ produkteve të prokuruar dhe të përcaktuara në DST dhe për këtë arsye do të duhet të hiqet.

* * *

5. Kërkesë për ekspertizë të posaçme □

Po

Jo

(Nëse po, specifikoni llojin e ekspertizës që kërkoni)

6. Kërkesë për përjashtim të zyrtarëve që do të merren me shqyrtimin e ankesës:

Jo

7. Lista e informacionit konfidencial:

Jo

Përcaktoni se cili informacion është konfidencial, nëse ka. Shpjegoni pse informacioni është ose një version i dokumenteve përkatëse me heqjen e pjesëve konfidenciale dhe një përmbledhje të përmbajtjes.

Kujdes: Ankimuesi duhet t'i bashkëlidhë ankimit, që do të paraqesë në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës së prokurimit, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe kopjet shtesë, pranë **Autoritetit/Enti Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.**

Shënim: Ankimuesi duhet ta dërgojë njëkohësisht ankesën në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit publik

Nr. i faksit:

E-mail:

info@inpress.al

Nënshkrimi dhe vula e Ankuesit

Administratori/Përfaqësuesi i autorizuar

Erald Dervishi